

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS**

**BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**



**Programi mësimor**

**Arti figurativ**

**për klasën IV**

**Shkup, 2021**

## TË DHËNA THEMELORE PËR PROGRAMIN MËSIMOR

<b>Lënda mësimore</b>	<b>Arti figurativ</b>
<b>Lloji/kategoria e lëndës mësimore</b>	E obligueshme
<b>Klasa</b>	IV (katërt)
<b>Temat/fushat në programin mësimor</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Vizatimi</b></li> <li>• <b>Pikturimi</b></li> <li>• <b>Formësimi dhe ndërtimi plastik</b></li> <li>• <b>Grafika</b></li> <li>• <b>Dizajni dhe komunikimi vizual</b></li> </ul>
<b>Numri i orëve</b>	1 orë në javë /36 orë në vjet
<b>Pajisjet dhe mjetet</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mjete audio-vizuale (TV, DVD player, projektor LCD, kasetë, aparat fotografik digjital, kamerë digjitale, kompjuter, tabelë interaktive, tabletë për vizatim, printer ose pajisje tjetër digjitale).</li> <li>• Internet, softuerë edukativ.</li> <li>• Mjete dhe materiale për vizatim (letër, laps, ngjyra druri, flomasterë, ngjyra vaji, bajc, tush, pendë, shkumës, materiale natyrore dhe artificiale, këmbalec piktorësh).</li> <li>• Mjete dhe materiale për pikturim (akuarel, temperë, pastel, materiale për kolazh).</li> <li>• Mjete për formësim dhe ndërtim plastik (plastelinë, argjiri, brumi, plastikë, ambalazh, letër alumini, tel, pe, pëlhurë, rërë, borë, polistiren, etj.)</li> <li>• Mjete për shtyp (matricë, fletë grafike – ekzemplar, karton-shtyp etj.).</li> <li>• Mjete për dizajn dhe komunikim vizual (fotografi, spot, reklamë, ilustrim, ballinë, internet, strip, shenjë vizuale).</li> <li>• Mjete vizuale (vizatime, fotografi, punime, revista, libra, afishe, posterë, aplikacione, ilustrime, prospekte).</li> </ul>
<b>Normativi i kuadrit mësimor</b>	<p>Punën edukative-arsimore në klasën e katërt mund ta realizojë personi i cili është:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• profesor/arsimtar/mësues i mësimit klasor, VII/1 ose VI/1 (sipas KMK) dhe 240 SETK;</li> <li>• pedagog i diplomuar, VII/1 ose VI/1 (sipas KMK) dhe 240 EKTS.</li> </ul>

## LIDHSHMËRIA ME STANDARDET KOMBËTARE

Rezultatet e mësimit të përmendura në programin mësimor shpijnë në përvetësimin e kompetencave të mëposhtme të përfshira me fushën **Shprehja artistike dhe kultura** nga Standardet kombëtare:

<i>Nxënësi/nxënësja di dhe/ose është i aftë:</i>	
VIII-A.1	të manifestojë njohuri për format e ndryshme të shprehjes artistike nga të gjitha fushat e kulturës (letërsi, muzikë, arte pamore, arte interpretuese, arte dekorative, arkitekturë, dizajn),
VIII-A.3	t'i shprehë idetë, përvojat dhe emocionet e tyre, duke përdorur forma artistike ose të tjera të shprehjes krijuese (individuale ose kolektive),
VIII-A.4	për t'i interpretuar idetë, përvojat dhe emocionet e shprehura në produktet e artit të krijuara nga të tjerët që i përkasin kulturave së tyre ose të tjera,
VIII-A.5	të manifestojë njohuri për kulturën e vet dhe mënyrat e ndryshme të shprehjes së saj përmes letërsisë dhe arteve pamore, muzikës dhe vallëzimit, objekteve dhe produkteve të tjera kulturore,
VIII-A.6	t'i identifikojë dallimet dhe ngjashmëritë midis kulturës së vet dhe kulturave të tjera në mjedisin e vet më të ngushtë dhe më të gjerë dhe të analizojë lidhjen dhe ndërvarësinë e tyre.
<i>Nxënësi/nxënësja pranon se:</i>	
VIII-B.2	qëndrimi kritik ndaj veprave të ndryshme të artit është i rëndësishëm për zhvillimin e vlerave estetike individuale dhe shoqërore.

Programi mësimor gjithashtu përfshin kompetencat përkatëse në fushat e Standardeve kombëtare: **Shkrim-leximi digjital, Zhvillimi personal dhe social, Shoqëria dhe kultura demokratike, dhe Teknika, teknologjia dhe sipërmarrësia.**

<i>Nxënësi/nxënësja di dhe është i/e aftë:</i>	
IV-A.2	të vlerësojë kur dhe në çfarë mënyre është i nevojshëm edhe përdorimi efektiv i TIK për të zgjidhur një detyrë/problem;
IV-A.5	të përcaktojë se çfarë informacioni i nevojitet, të gjejë, të zgjedhë dhe të shkarkojë të dhëna, informacione dhe përmbajtje digjitale;
IV-A.8	t'i përdore përmbajtjet digjitale, rrjete arsimore dhe sociale dhe retë digjitale në mënyrë të sigurt dhe të përgjegjshme;
V-A.4	të bëjë vlerësim të aftësive dhe arritjet e tija/saja (duke përfshirë pikat e forta dhe të dobëta) dhe mbi atë bazë të përcaktojë prioritetet që do t'i mundësojnë atij/saj të zhvillohet dhe përparojë;
V-A.6	të vendosë synime për të mësuar dhe zhvillim personal dhe të punojnë për tejkalimin e sfidave që paraqiten në rrugën drejt arritjes së tyre;
V-A.7	t'i përdorë përvojat e veta për ta lehtësuar mësimin dhe për ta përshtatur sjelljen e vet në të ardhmen;
V-A.10	të zbatojë parimet etike në vlerësimin e të drejtës dhe të gabuarës në veprimet e veta dhe të të tjerëve dhe të shfaqë tipare të virtytshme të karakterit (siç janë: ndershmëria, drejtësia, respekti, durimi, kujdesi, mirësjellja, mirënjohja, vendosmëria, guximi dhe vetë disiplina);

V-A.14	të dëgjojë në mënyrë aktive dhe të reagojë në mënyrë të përshtatshme, duke treguar empati dhe mirëkuptim për të tjerët dhe duke shprehur shqetësimet dhe nevojat e veta në mënyrë konstruktive;
V-A.15	të bashkëpunojë me të tjerët në arritjen e qëllimeve të përbashkëta, duke ndarë pikëpamjet dhe nevojat e veta me të tjerët dhe duke marrë parasysh pikëpamjet dhe nevojat e të tjerëve;
V-A.17	të kërkojë informacion kthyes dhe mbështetje për veten, por gjithashtu të ofrojë informacione kthyes dhe mbështetje konstruktive në dobi të të tjerëve;
V-A.19	të japë sugjerime, të marre parasysh mundësitë e ndryshme dhe t'i parashikojë pasojat në mënyrë që të nxjerrë përfundime dhe të marre vendime racionale;
V-A.21	ta analizojnë, vlerësojnë dhe përmirësojnë të mësuarit e vet;
VI-A.5	t'i kuptojë dallimet midis njerëzve mbi çfarëdo baze (përkatësia gjinore dhe etnike, mosha, aftësitë, statusi social, etj.);
VI-A.6	ta njohë praninë e stereotipave dhe paragjyqimeve mes vetes dhe të tjerëve dhe të kundërshtojë diskriminimin;
VII-A.4	të gjenerojë ide dhe krijojë aktivitete që çojnë në produkte dhe/ose shërbime;
VII-A.9	të marrë pjesë aktivisht në punën ekipore sipas rregullave të miratuara më parë dhe me respekt të vazhdueshëm për rolin dhe kontributin e të gjithë anëtarëve të ekipit.
<i>Nxënësi/nxënësjat kupton dhe pranon se:</i>	
IV-B.1	shkrim-leximi digjital është thelbësor për jetën e përditshme – e lehtëson mësimin, jetën dhe punën, kontribuon në zgjerimin e komunikimit, krijimtarisë dhe inovacionit, ofron mundësi të ndryshme për argëtim;
IV-B.5	informacioni i disponueshëm në hapësirën digjitale duhet të përdoret në mënyrë etike, sipas rregullave të përcaktuara dhe për të mirën e njerëzve;
V-B.3	arritjet personale dhe mirëqenia e dikujt në masë të madhe varen nga puna që ai/ajo investon dhe rezultatet që i arrin;
V-B.4	çdo veprim që e ndërmerret ka pasojat për të/saj dhe/ose mjedisin e tij/saj;
V-B.7	iniciativa, këmbëngulja dhe përgjegjësia janë të rëndësishme për zbatimin e detyrave, arritjen e qëllimeve dhe tejkalimin e sfidave në situatat e përditshme;
V-B.8	ndërveprimi me të tjerët është i dyanshëm - ashtu siç ka të drejtë t'i kërkojë të tjerëve që t'i mundësojnë atij/asaj të jetë i kënaqur me interesat dhe nevojat e tij/saj, po ashtu edhe ai/ajo ka përgjegjësi t'u japë hapësirë të tjerëve për të kënaqur interesat dhe nevojat e tyre;
V-B.9	kërkimi i informacionit kthyes dhe pranimi i kritikës konstruktive shpie në përparim personal në planin individual dhe social;
VI-B.9	çdo qytetar duhet të marrë përgjegjësinë për ndryshimet në natyrë të shkaktuara nga aktivitetet njerëzore;
VII-B.4	etika e punës, ndjeshmëria kulturore dhe qëndrimi ndaj të tjerëve janë të rëndësishme për krijimin dhe ruajtjen e një klime pozitive pune.

## REZULTATET NGA MËSIMI

<p>Tema: <b>VIZATIMI</b></p> <p>Numri i përgjithshëm i orëve: <b>9</b></p>	
<p><b>Rezultatet ngamësimi</b></p> <p>Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë të:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. krijojë vizatim, duke përdorur lapsin, shkumësat, tush, bajc, pendë, dru, thëngjill;</li> <li>2. aplikon baraspeshën, kontrastin, gradimin, proporcionin, simetrinë, asimetrinë, vëllimin, detajet, vijat kontrastet dhe vijat e profileve kur vizaton dhe ta njohë praninë e elementeve dhe parimeve të njëjta në vizatimet e të tjerëve.</li> <li>3. Përdor kompjuter për krijimin e vizatimit.</li> </ol> <p>Nxënësi/nxënësja do ta:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>4. zhvillojë krijimtarinë përmes vizatimit.</li> </ol>	
<p><b>Përmbajtjet (dhe konceptet)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mjete për vizatim dhe përdorimi i tyre (letër, laps, shkumës, tush, bajc, pendë, dru, thëngjill).</li> <li>• Bazat e gjuhës artistike: elementet dhe parimet figurative në vizatim.</li> <li>• Baraspesha, kontrasti, gradimi, proporcioni, vëllimi, simetria, asimetria, tërësia, detali, vijat e profilit.</li> </ul>	<p><b>Standardet e vlerësimit</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• I identifikon mjetet me të cilat ai mund të vizatojë.</li> <li>• Përdor mjete të ndryshme vizatimi kur krijon një vizatim.</li> <li>• Dallon vizatimet e bëra duke përdorur mjete të ndryshme vizatimi .</li> <li>• Vizaton motive nga mjedisi, fenomenet natyrore, ngjarjet e jetës së përditshme duke përdorur linja të ndryshme, duke përfshirë kontrastin dhe konturimin.</li> <li>• I njeh ndryshimet në pamjen e vizatimit kur përdoren elemente dhe parime të ndryshme artistike.</li> <li>• E identifikon detajin në tërësi (vizatimi i dhënë).</li> <li>• Vizaton motive simetrike dhe asimetrike.</li> <li>• I njeh mjetet dhe elementet artistike të cilat i mëson në vizatimet e autorëve të famshëm.</li> <li>• Vizaton forma të ndryshme duke përdorur një kompjuter.</li> <li>• E vlerëson vizatimin e tij ose vizatimin e shokut të klasës nga aspekti i zbatimit të elementeve dhe parimeve artistike që ai/ajo i ka përvetësuar.</li> </ul>
<p><b>Shembuj të aktiviteteve</b></p>	

- Nxënësit vizatojnë një peizazh duke vëzhguar drejtpërdrejt mjedisin e afërt, duke përdorur linja të ndryshme (vertikale, horizontale, diagonale, të trasha, të holla, të lakuara, të drejta) dhe material vizatimi sipas zgjedhjes së tyre (duke ndjekur vizatimet e Van Gogut).
- Nxënësit vizatojnë një “natyrë të vdekur” duke vëzhguar një model (një pjatë me fruta, një vazo ose një tas) me tush dhe pendë.
- Nxënësit vizatojnë një “natyrë të vdekur” duke vëzhguar një model të thjeshtë (fruta, vazo ose pjatë) në kompjuter/tabletë.
- Nxënësit vizatojnë një fragment të një veshje popullore - një model, karakteristik për një bashkësi etnike në vendin tonë me tush, bajc ose thëngjill.
- Nxënësit vizatojnë “forma gjeometrike 3D” (piramidë, katror, kub, prizëm) me laps (duke ndjekur vizatimet e Escher).
- Nxënësit krijojnë një vizatim nga kujtesa (nga një udhëtim/ekskursion), duke vizatuar një relief (male, lugina, gryka, lumenj dhe liqene) dhe burime natyrore (pyje, lumenj, liqene, diell), dhe përdorin flomasterë, ngjyra prej druri ose vaji.
- Me shkumës me ngjyrë, nxënësit vizatojnë në dyshtet e oborrit të shkollës për temën e dhënë (për shembull, ekologjia - mbrojtja e mjedisit).
- Nxënësit vizatojnë me shkumës një kryqëzim trafiku në oborrin e shkollës. Vizatimi përdoret për të simuluar lëvizjen e këmbësorëve, shoferëve, çiklistëve, njerëzve në patina, skutera etj., duke respektuar rregullat e sjelljes në komunikacion.
- Nxënësit vizatojnë simbolet e komunës (flamurin dhe stemën), pas kërkimeve të mëparshme në internet.
- Nxënësit vizatojnë pajisje sportive, vegla muzikore dhe/ose kafshë me vija konture dhe material vizatimi sipas zgjedhjes së tyre.
- Nxënësit përmes vizatimit paraqesin një kompozicion simetrik dhe asimetrik të motiveve të ndryshme - flutur, brumbuj, lule, etj. Ato priten dhe ngjiten në një copë druri (të bërë më parë nga mësuesi). Punojnë me një larmi materiale të vizatimit me ngjyra.
- Nxënësit prezantojnë motivet e një boçe, afioni dhe kërmilli, duke vizatuar linja të ndryshme dhe duke përdorur materiale vizatimi dhe duke përdorur kompjuter.

<p>Tema: <b>PIKTURIMI</b></p> <p>Numri i përgjithshëm i orëve: <b>15</b></p>	
<p><b>Rezultatet nga mësimi</b></p> <p>Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë të:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. krijojë pikturë, duke përdorur teknika dhe materiale të ndryshme pikturimi;</li> <li>2. e aplikon gradimin e ngjyrave dhe toneve, ngjyra kromatike dhe akromatike dhe kontrast komplementar gjatë pikturimit;</li> <li>3. e përdor kompjuterin për krijimin e pikturës.</li> </ol> <p>Nxënësi/nxënësja do:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>4. ta zhvillojë krijimtarinë përmes pikturimit.</li> </ol>	
<p><b>Përmbajtjet (dhe konceptet)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mjetet për pikturim dhe përdorimi i tyre në teknika të ndryshme të pikturës (akuarel, guash, temperë, pastel, material kolazhi, flomasterë, tush).</li> <li>• Bazat e gjuhës artistike: elementet dhe parimet artistike në pikturim.</li> <li>• Baraspesha, kontrasti, gradimi, proporcioni, vëllimi, ngjyrat kromatike dhe akromatike, gradimi i ngjyrave dhe toneve, kontrasti komplementar, çiftet komplementare.</li> </ul>	<p><b>Standardet e vlerësimit</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• I identifikon mjetet me të cilat ai mund të pikturojë.</li> <li>• Përdor një mjete të ndryshme për pikturim kur krijon një pikturë.</li> <li>• I dallon pikturat e bëra duke përdorur mjete të ndryshme të pikturës.</li> <li>• I kombinon mjetet dhe sfondet e ndryshme për pikturë dhe krijon një pikturë.</li> <li>• I dallon ngjyrat dhe tonet në mjedis dhe i paraqet duke pikturuar.</li> <li>• Pikturon në kompjuter duke përdorur programe të përshtatura.</li> <li>• Krijon një pikturë me gradim të ngjyrave akromatike dhe kromatike.</li> <li>• E identifikon kontrastin komplementar dhe e zbaton atë kur krijon piktura dhe kolazhe.</li> <li>• E vlerëson pikturën e tij/saj ose një pikturë të shokut të klasës nga aspekti i zbatimit të elementeve dhe parimeve artistike që ai/ajo i ka përvetësuar.</li> </ul>
<p><b>Shembuj të aktiviteteve</b></p> <p>Nxënësit pikturojnë një motiv të natyrës së vdekur me fruta të ndryshme, duke theksuar simetrinë, raportin e madhësisë, proporcionin dhe vëllimin. Nxënësit përdorin shkumës, pastel, temperë ose vizatojnë në kompjuter.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nxënësit pikturojnë një motiv bazuar në një vëzhgim të mëparshëm të një veprë arti nga një artist i famshëm (për shembull, një vepër e Vasily Kandinsky). Duke vepruar kështu, ata përdorin vetëm ngjyrat e ftohta të spektrit dhe teknikat e pikturës guash, temperë ose pikturojnë në kompjuter.</li> <li>• Nxënësit, duke përdorur ngjyrën, tonin dhe formën, pikturojnë zjarrin si motiv. Duke vepruar kështu, ata përdorin vetëm ngjyrat e ngrohta të spektrit dhe teknikat e pikturës gouache dhe temperë.</li> <li>• Nxënësit bëjnë një kompozicion të bazuar në gjethet e vjeshtës dhe vjeshtës, duke aplikuar gradimin tonal të ngjyrave (me shtimin e të bardhës ose të zezës) në guash ose temperë.</li> </ul>	

- Nxënësit pikturojnë lulëkuqe në livadh, duke aplikuar kontrast komplementar (gjegjësisht ngjyra e kuqe dhe e gjelbër). Duke vepruar kështu, ata përdorin një kolazh me letër me ngjyrë si një material arti (duke ndjekur shembujt e Paul Gauguin ose Van Gogut).
- Nxënësit pikturojnë me ngjyra të ngrohta dhe të ftohta sipas një motivi fushe ose një vazo me luledielli duke përdorur guash, temperë dhe pastel (duke ndjekur Van Gogun).
- Nxënësit pikturojnë sipas shembullit të një vepre të artit modern (Victor Vasarely ose Juan Mirro) duke përdorur harmoninë e ngjyrave dhe hapësirës në guash, temperë ose kompjuter.
- Nxënësit pikturojnë motive garash me makinë në një kompjuter, duke përdorur hapësirën dhe drejtimin.
- Nxënësit pikturojnë një motiv oborr fshati me guash, ngjyra temperë dhe pastel (hapësira: majtas-djathtas).
- Nxënësit e eksplorojnë lidhjen e kontrasteve përmes ngjyrës dhe formës, duke krijuar një motiv sipas veshjeve tradicionale popullore nga bashkësi të ndryshme etnike në vendin tonë me guash, temperë ose kompjuter.
- Nxënësit përdorin një ritëm ngjyrash dhe formash kur pikturojnë një motiv të një ndeshje futbolli në guash dhe temperë.
- Nxënësit pikturojnë enë të ndryshme shtëpiake në proporcion, duke përdorur pastel.

Tema: **FORMËSIMI DHE NDËRTIMI PLASTIK**

Numri i përgjithshëm i orëve: 5

#### **Rezultatet nga mësimi**

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:

1. krijon forma, duke përdorur teknika dhe materiale të ndryshme për formësimin në hapësirë, modelim dhe ndërtim;
2. aplikon elemente dhe parime artistike në formësimin dhe ndërtimin e relievit, portretit, bustit, skulpturës, figurave tre-dimensionale dhe arkitekturës;
3. përdor kompjuter për formësimin plastik dhe ndërtimin.

Nxënësi/nxënësja do:

4. ta zhvillojë krijimtarinë përmes formëimit plastik dhe ndërtimit.



Përmbajtjet (dhe konceptet)	Standardet e vlerësimit
<ul style="list-style-type: none"> <li>Mjete dhe materiale për formësim plastik dhe ndërtim dhe përdorimi i tyre (letër, plastelinë, argjiri, brumi, plastikë, ambalazh, letër alumini, tel, pe, pëlhurë, rërë, borë, polistiren).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>I identifikon mjetet dhe materialet me të cilat mund të formësojë, modelojë dhe ndërtojë.</li> <li>Përdor mjete dhe materiale të ndryshme për formësimin plastik dhe ndërtimin.</li> <li>Dallon format dhe strukturat, të formësuara duke përdorur mjete dhe materiale të ndryshme.</li> <li>Kombinon mjete dhe materiale të ndryshme për formësim plastik dhe ndërtimin dhe krijon forma dhe struktura.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Bazat e gjuhës artistike: elementet dhe parimet artistike në formësimin plastik dhe ndërtimin.</li> <li>Formësimi plastik, modelimi, ndërtimi, figura tre-dimensionale, proporcioni, vëllimi, perforimi, relievi, portreti, buste, skulptura, arkitektura, asamblazh.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Bën dallimin midis formave dy-dimensionale dhe tre-dimensionale në mjedis dhe i paraqet ,formësim plastik dhe ndërtim.</li> <li>Përdor programe kompjuterike të përshtatura për formësim dhe ndërtim.</li> <li>Krijon një formë ose strukturë duke përdorur proporcione, vëllim, tërësi, detaje dhe perforim.</li> <li>Bën dallimin midis relievit, portretit, bustit, skulpturës, asamblazhit dhe arkitekturës.</li> <li>Vlerëson punën e tij/saj ose të shokut të klasës nga aspekti i zbatimit të elementeve dhe parimeve artistike që ai/ajo i ka përvetësuar.</li> </ul>
<p><b>Shembuj të aktiviteteve</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Nxënësit përdorin kuti kartoni, material të ricikluar, plastikë, etj. (teknikë asamblazh) për të krijuar një kompozim të peizazhit të lirë me një motiv urban.</li> <li>Nxënësit përdorin argjilën për të krijuar një kompozicion voluminoz me motiv natyre (për shembull, sythat e luleve, frutat) me qëllim të përdorimit të teksturës në formë.</li> <li>Nxënësit krijojnë një formë gjysmë të hapur me motiv të pëllëmbës, duke përdorur materiale skulpturore (si argjila).</li> <li>Nxënësit formojnë një formë të hapur me motiv pranveror të bërë në teknikën e kolazhit/asamblazhit (copa kartoni, shkopinj druri, plastikë, etj.);</li> <li>Nxënësit përdorin një copë letër për të krijuar një formë relievi me motiv natyre (për shembull, kodër, mal, varg malor).</li> <li>Nxënësit krijojnë forma gjeometrike të madhësive të ndryshme. Kështu, materialet kombinohen, siç janë: tela, letër, ngjyrë, pëlhurë, etj.;</li> <li>Nxënësit përdorin argjilën ose plastelinën dhe formojnë një figurë të njeriut të ulur në një kub duke aplikuar volumin në një hapësirë (siç është dhënë në ilustrimin).</li> <li>Nxënësit përdorin argjilën dhe plastelinën për të formuar një shitës tregu duke përdorur forma të kundërta.</li> <li>Nxënësit formojnë me argjilë dy ose më shumë figura, person në moshë dhe madhësi të ndryshme duke përdorur forma të kundërta.</li> <li>Nxënësit formojnë me argjilë dy ose më shumë figura të kafshëve të madhësive të ndryshme (shembull: zog dhe pulë) duke përdorur forma të kundërta.</li> </ul>	

<ul style="list-style-type: none"> <li>Nxënësit formojnë modele - monumente me materialin e zgjedhur (kompozojnë forma të thjeshta dhe komplekse) bazuar në një model të skulpturave ekzistuese.</li> <li>Nxënësit përdorin paketim të ricikluar për të ndërtuar ose bërë model të një shtëpie, ndërtese apartamentesh, fabrike, etj.</li> </ul>	
<p>Tema: <b>GRAFIKA</b></p> <p>Numri i përgjithshëm i orëve: <b>3</b></p>	
<p><b>Rezultatet nga mësimi</b></p> <p>Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë të:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>krijon matrica duke përdorur teknika të ndryshme dhe mjetesh për printim;</li> <li>aplikon elemente dhe parime artistike në printim – monotipi, kolografi;</li> <li>përdor kompjuter, printer për printim.</li> </ol> <p>Nxënësi/nxënësja do:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>ta zhvillojë krijimtarinë përmes grafikës.</li> </ol>	
<b>Përmbajtjet (dhe konceptet)</b>	<b>Standardet e vlerësimit</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Mjetet për printim dhe aplikimi i tyre (matrica, fletë grafike – modeli, karton-model).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Identifikon dhe përdor mjetet të ndryshme për printim.</li> <li>Bën dallimin midis mjeteve të ndryshme për printim.</li> <li>Kombinon mjete të ndryshme për printim për të krijuar një print grafik.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Bazat e gjuhës artistike: elemente dhe parime artistike në grafikë (grafika, monotipia, kolografia).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Krijon një print grafik duke përdorur teknika të ndryshme grafike, elementet dhe parimet artistike në printim.</li> <li>Bën dallimin midis monotipit dhe kolografisë në printim.</li> <li>Printon duke përdorur kompjuter, duke përdorur printer dhe programe të përshtatura.</li> <li>E vlerëson printimin e tij/saj ose printin e shokut të klasës nga aspekti i zbatimit të elementeve dhe parimeve artistike që ai/ajo i ka përvetësuar në printim.</li> </ul>
<p><b>Shembuj të aktiviteteve</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Nxënësit printojnë një grafik të motivit të shpendëve me një model kartoni me temperë të zi për të treguar formën, kontrastin, madhësinë dhe proporcionin.</li> <li>Nxënësit printojnë një formë grafike me teknikën monotip, duke bërë një kartolinë ditëlindjeje, Viti i Ri, 8 Marsi. Ata përdorin ngjyra temperë dhe foli plastike ose alumini si një shtresë për printim dhe e prezantojnë kompozicionin.</li> <li>Nxënësit printojnë një formë grafike në letër duke përdorur teknikën e kolografisë. Në këtë mënyrë, ata bëjnë printime duke ngjitur pëlhura të ndryshme, litar, pe, etj., në mënyrë që të arrijnë forma artistike me efekte të teksteve dhe strukturave të ndryshme.</li> </ul>	

- Nxënësit bëjnë shabllone nga plastika ose kartoni dhe i përdorin për të printuar në kanavacë në mënyrë që të marrin një pëlhurë me model dekorativ.
- Nxënësit bëjnë një bazë (matricë) nga argjila dhe krijojnë një motiv duke gdhendur dhe formësuar. Pastaj, ata e pikturojnë dhe e kopjojnë në një copë letër.
- Nxënësit gjejnë vepra arti grafike në internet dhe e printojnë në një printer.

Tema: **DIZAJNI DHE KOMUNIKIMI VIZUAL**

Numri i përgjithshëm i orëve: 4

### Rezultatet e mësimit

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë të:

1. krijon dizajn, duke përdorur teknika, mjete dhe materiale të ndryshme për dizajn dhe komunikim vizual;
2. zbaton elemente dhe parime artistike në dizajn dhe komunikime vizuale - ilustrim, kopertinë, reklamë, strip komik, video, shenjë vizuale, fotografi;
3. përdor kompjuter dhe pajisje digjitale në dizajn dhe komunikime vizuale.

Nxënësi/nxënësja do:

4. ta zhvillojë krijimtarinë përmes dizajnit.

### Përmbajtjet (dhe konceptet)

- Mjetet dhe materialet për dizajn dhe komunikime vizuale dhe përdorimi i tyre (letër, ngjyra, pëlhura, materiale ekologjike, kompjuter, telefon, aparat për fotografi, kamerë digjitale, etj.)

- Bazat e gjuhës artistike: elemente dhe parime artistike në dizajn dhe komunikime vizuale (dizajn, komunikime vizuale, ilustrim, kopertinë, reklamë, strip komik, spot, shenjë vizuale, fotografi etj.).

### Standardet e vlerësimit

- I identifikon dhe përdor mjetet dhe materialet e ndryshme për dizajn dhe komunikime vizuale.
- Bën dallimin midis mjeteve dhe materialeve të ndryshme për dizajnin dhe komunikimet vizuale.
- Kombinon mjete dhe materiale të ndryshme për dizajn dhe komunikime vizuale për të krijuar dizajnin si produkt.
- Krijon dizajn duke përdorur teknika të ndryshme, elemente dhe parime artistike në dizajn dhe komunikime vizuale, duke përdorur teknologji moderne.
- Bën dallimin midis dizajnit të punuar me dorë dhe dizajnit të bërë në formë elektronike ose digjitale.
- Dallon dizajnin e ilustrimit, kopertinës, reklamës, komikut, videos, shenjës vizuale, fotografisë.
- E vlerëson dizajnin e vet ose dizajnin e shokët të klasës sa i përket zbatimit të elementeve dhe parimeve artistike që ai/ajo i ka përvetësuar në dizajn dhe komunikimet vizuale.

### Shembuj të aktiviteteve

- Nxënësit dizajnojnë një copë veshje nga materiali natyror ekologjik.
- Nxënësit dizajnojnë një model ose motiv për një sipërfaqe tekstili, bazuar në një motiv artisti (për shembull, Pete Mondrian, pop art ose arti popullor nga bashkësi të ndryshme etnike në vend), duke lidhur ngjyra, forma, linja, ritëm, përsëritje, kompozicion.
- Nxënësit dizajnojnë një maskë për të shënuar ngjarjet (për shembull: 1 prilli, Viti i ri, karnavalet, etj.), duke përdorur material për kolazh dhe formësim.
- Nxënësit dizajnojnë strip komik duke përdorur copëza të vjetra gazete ose fotografi të personazheve të preferuar.
- Nxënësit krijojnë një dizajn të kopertinës (të një libri, strip komik, broshurë, revistë, etj.) sipas një teksti që përpunohet në lëndën e gjuhës amtare. Ata përdorin një kompjuter si mjet shprehjeje.
- Nxënësit bëjnë një video spot dhe/ose reklamë në nivel shkolle, duke përdorur një kompjuter dhe pajisje të tjera digjitale për të dizajnuar.
- Nxënësit dizajnojnë një album fotografish të nivelit të klasës duke përdorur fotografitë e tyre të bëra nga aparati digjital.

## INKLUZIVITETI, BARAZIA/NDJESHMËRIA GJINORE, NDËRKULTURA DHE INTEGRIMI MES LËNDËVE

Mësuesi siguron inkluzivitet duke përfshirë të gjithë nxënësit në të gjitha aktivitetet gjatë orës së mësim. Ai i mundëson secilit fëmijë të angazhohet në mënyrë njohëse dhe emocionale përmes përdorimit të qasjeve të përshtatshme (individualizimi, diferencimi, puna në grup, mbështetja e shokëve në klasë). Gjatë punës me nxënës me aftësi të kufizuara, aplikon një plan arsimor individual (me rezultate të përshtatura të të mësuarit dhe standarde vlerësimi) dhe, kur është e mundur, përdor mbështetje shtesë nga persona të tjerë (asistentë personal dhe arsimor, ndërmjetësues arsimor, tutorë vullnetarë dhe profesionistë nga shkollat e qendrave resurse). Monitoron të gjithë nxënësit rregullisht, veçanërisht ata nga grupet e cenueshme, në mënyrë që të jetë në gjendje të identifikojë vështirësitë e të mësuarit në kohën e duhur, për t'i inkurajuar dhe mbështetur ata në arritjen e rezultateve nga të mësuarit.

Gjatë realizimit të aktiviteteve, mësuesi i trajton njësoj si djemtë ashtu edhe vajzat, duke u kujdesur që të mos u caktojë role stereotipike gjinore. Kur formon grupe pune, ai përpiqet të sigurojë baraspeshën gjinore. Gjatë përzgjedhjes së materialeve shtesë në mësimdhënie, përdor ilustrime dhe shembuj që janë gjinorë dhe të ndjeshëm nga pikëpamja etnike/kulturore dhe inkurajojnë barazinë gjinore, d.m.th. promovojnë ndërkulturizmin. Gjithashtu, mësuesi është i kujdesshëm që të mos transmetojë stereotipat gjinore dhe etnike në veprat e nxënësve.

Gjithmonë kur është e mundur, mësuesi përdor integrimin e aktiviteteve/koncepteve nga lënda **Arti figurativ** me përmbajtjen/standartet nga lëndët e tjera në planifikimin dhe realizimin e mësim. Në këtë mënyrë, kjo lëndë i motivon nxënësit në mësimin e lëndëve të tjera dhe ndihmon në zotërimin e tyre më të lehtë.

## VLERËSIMI I TË ARRITURAVE TË NXËNËSVE

Për t'iu mundësuar nxënësve të arrijnë standardet e pritshme të vlerësimit, mësuesi monitoron dhe vlerëson rregullisht arritjet e nxënësve gjatë mësimit. Treguesit mbledhen për aktivitetet e tyre, motivimin për krijimin e artit, angazhimin, përkushtimin në punë, punën individuale, tandem dhe në grup. Për pjesëmarrjen në aktivitete, nxënësit marrin informacione kthyesë të cilat tregojnë nivelin e suksesit në realizimin e aktivitetit/detyrës dhe japin udhëzime për përmirësim (vlerësim formues). Për atë qëllim, mësuesi monitoron dhe vlerëson:

- përgjigjet me gojë ndaj pyetjeve të parashtruara nga mësuesi ose shoku i klasës;
- aktiviteti praktik gjatë orëve të mësimit (pjesëmarrja në aktivitete);
- veprat e punuara të artit (vizatimi, pikturimi, formësimi plastik dhe ndërtimi, grafika, dizajni dhe komunikime vizuale);
- pjesëmarrja në punimin e veprave të përbashkëta.

Gjatë monitorimit të arritjeve të nxënësve, mësuesi duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë qasjes individuale ndaj arritjeve të secilit nxënës individualisht. Në fund të vitit, bëhet një vlerësim përshkruar përmblendës i standardeve të arritura të vlerësimit. Në fund të vitit shkollor, nxënësi merr një notë numerike.

<b>Fillimi i zbatimit të programit mësimor</b>	viti 2021/2022
<b>Institucioni/përfaqësuesi i programit</b>	Byroja e Zhvillimit të Arsimit
<b>Në pëlqim me nenin 30, paragrafi 3 nga Ligji për arsim fillor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 161/19 dhe 229/20) ministrja e Arsimit dhe Shkencës e miratoi këtë program mësimor nga lënda e <i>Artit figurativ për klasën IV</i>.</b>	nr. 08-7413/8 10.05.2021  Ministrja e Arsimit dhe e Shkencës, Milla Carovska, n.p.